




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKAKOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	30.04.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	2155/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.160/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën e datës 19.03.2021 me numër A.nr.160/2021 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike *"masë disiplinore-vërejtje"*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si bazuar ankesa numër A.nr.160/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET Vendimi me numër protokoll 0470 të datës 01.03.2021 i Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Vendimi me nr.0300 i datës 03.02.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor, si dhe të gjitha vendimet tjera që rrjedhin nga ky vendim.

III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në vendin e punës "Udhëheqës i Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, sipas Akte emërimit të datës 03.09.2012, i transferuar me Vendimin nr.4391 të datës 24.12.2019, me datë 03.02.2021 Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues i Kosovës, ka rekomanduar inicim të procedurës disiplinore me Rekomandim nr.0298, me dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, për

virtësit e tij, të vlerësuar me nota të larta mbi 4,30 ,të cilat nuk janë të arsyetuara dhe reale duke dyshuar se nuk është zbatuar Rregullorja për vlerësim në fuqi. Ankuesi është njoftuar përmes E-mailit zyrtar të datës 04.02.2021 nga zyra e personelit, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij.

Komisioni Disiplinor me datë 01.03.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 0470 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar vërejtje nga neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtar Publik.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër protokolli 0470 e datës 01.03.2021 të Komisionit Disiplinor, me datë 19.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër 1279/2021 me pretendimet ankimore se vërejtja e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor është e kundërligjshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 24.03.2021 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Me datë 29.04.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë në forme elektronike, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga 1/55 faqe.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 1279/210 të datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 04.02.2021 për iniciim të procedurës disiplinore, bashkangjitur njoftimin me rekomandim të datës 03.02.2021 nr.009; E-mail zyrtar i datës 03.03.2021, lidhur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 01.03.2021 me nr. 0470; Rekomandim nr.0298 i datës 03.03.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës për iniciim të procedure disiplinore; E-mail i datës 26.11.2020, lidhur me komunikimin zyrtar në mes ankuesit dhe udhëheqësit të tij, për vlerësimin e punës 2020, E-maili i datës 20.11.2020, E-maili i datës 19.11.2020, prej 1/5 faqe; E-maili i datë 28.12.2020 nga Zëvendës Drejtorja e Qendrës së Paraburgimit nga ½ faqe, bashkangjitur raportin i përgjithshëm i vlerësimit 2020 nga 1/6 faqe; E-mail i datës 08.02.2021 ftesë për seancë nga Komisioni disiplinor; Procesverbali datës 11.02.2021, ½ faqe; Kërkesë për përgjigje në ankese nga Këshilli me datë 24.03.2021; Përgjigje në ankesë në forme elektronike nga Shërbimi Korrektues, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga 1/55 faqe; Vendimi nr.4391 i datës 24.12.2019 mbi transferimin; Akte emërimit të datës 03.09.2012; E-maili datës 19.11.2021, të bashkangjitur formularët e vlerësimit të punës për vitin 2020, prej ½ faqe; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, datës 14.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, znj i datës 14.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, i datës 14.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, i datës 11.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, z i datës 14.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, datës 14.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, Qullumi i datës 14.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, datës 14.12.2020; Kërkesë për provë shtesë E-mail i datës 29.04.2021 për menaxherin e personelit në SHKK; Përgjigje E-mail i datës 29.04.2021 në kërkesë, bashkangjitur Vendimin mbi themelimin e komisionit disiplinor, si dhe Vendimi nr.0523 i komisionit disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, i ndryshuar me datë 19.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, SEPSE,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas nenit 4 paragrafit 1 ku përcakton se: *"nëpunësit profesional të shërbimit korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë"*, ku marrëdhënia e punës rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Më datë 03.02.2021 Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues i Kosovës, ka inicuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor ndaj ankuesit me dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, për vartësit e tij, të vlerësuar me nota të larta mbi 4,30 të cilat nuk janë të arsyetuara dhe reale, duke dyshuar se nuk është zbatuar Rregullorja për vlerësim në fuqi dhe ka bërë shkelje të detyrave të tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues i Kosovës, me datë 03.02.2021 ka nxjerrë Vendimin me nr.0300 për themelimin e Komisionit Disiplinor për këtë rast. Ndërsa Komisioni Disiplinor me datë 01.03.2021 ka nxjerrë Vendimin me nr.0470, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"vërejtje"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankuesit i cili pretendon se vërejtja e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër 0470 të datës 01.03.2021, është shqiptuar kundërligjshëm, të cilat pretendime Kolegji ka konstatuar se janë të bazuara sepse, Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me nr.0470 të datës 01.03.2021, ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore duke rënë ndesh me dispozitat ligjore të nenit 48 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: *"Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"* sepse shqiptimi i masave disiplinore *"Vërejtje"*, në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të këtij ligji, kjo kompetencë është vetëm e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit gjegjësisht e Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit, duke u lidhur me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se: *"1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit"*, dhe neni 13 *"1. Kompetent për shqiptimin e masave disiplinore sipas kësaj Rregullore janë: 1.1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë..." 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë shqipton masën disiplinore të përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit"*, andaj duke u lidhur me pretendimet e ankuesit është konstatuar se Komisioni disiplinor ka kompetencë në bazë të nenit 13 paragrafit 3 të njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"3. Komisioni disiplinor shqipton masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 deri 1.4 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 të Ligjit"*, dhe vendimi si i tillë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me shqiptimin e masës disiplinore *"vërejtje"*, në bazë të kompetencës së tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 03.02.2021 ka nxjerrë Vendimin me nr.0300 për themelimin e Komisionit Disiplinor duke vepruar në kundërshtim me nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: *"1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë"*

përgjegjëse", lidhur me nenin 10 të paragrafin 1 dhe paragrafin 7 Rregullores (QRK)Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se: " 1. Çdo institucion i administratës publike i cili ka në marrëdhënie pune nëpunës civilë themelon një komision disiplinor për shqiptimin e masave disiplinore në rast të shkeljeve të rënda disiplinore të parashikuara në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafit 3.1 deri 3.11 të Ligjit", dhe paragrafin 7 përcaktohet se " Për agjencitë ekzekutive të cilat nuk kanë struktura përgjegjëse për funksionet e brendshme administrative sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, funksionet e Komisionit Disiplinor i kryen ministria amë".

Andaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore është konstatuar se Drejtoria e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, me qenë se nuk ka strukturë përgjegjëse për funksionet e brendshme administrative e cila funksionon në kuadër të Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bazë të strukturës organizative të centralizimit, dhe e cila e ka të formuar komisionin disiplinor qendror,ka qenë e obliguar që të shqyrtoj edhe këtë rast të procedurës disiplinore nga se është njësi e saj,të iniciuar nga Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe mbi këtë bazë është vërtetuar se Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues me rastin e themelimit të komisionit disiplinor Vendimi me nr.0300 i datës 03.02.2021, si të veçantë për shqyrtimin e rastit të ankuesit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartë cekura, andaj mbi këtë bazë është i obliguar që në pajtim me këtë vendim të ndërmarr të gjitha veprimet juridike që ky vendim të zbatohet në përputhje të plotë me dispozitivin e tij.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.160/2021, me datë 30.04.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë ;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

